

VENDIM
Nr. 5, datë 1.2.2017

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN “PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe neni 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 58, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, nenit 59, pikat 2 dhe 3, dhe të nenit 60, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.7.2013, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Përmbajtja e nenit 6 ndryshon si më poshtë vijon:

1. Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezikun, si shumë e elementeve të mëposhtme:

a) zërave të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme, të ponderuara me rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpatisë, të llogaritura sipas Metodës Standarde, të përcaktuar respektivisht në kreun III dhe në kreun VI të kësaj rregulloreje;

b) kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, të llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në kreun VII të kësaj rregulloreje, të shumëzuara me 12.5;

c) kërkesës për kapital për rrezikun operacional, të llogaritur sipas Metodës së Treguesit të Thjeshtë ose sipas Metodës Standarde, të përcaktuara në kreun VIII të kësaj rregulloreje, të shumëzuara me 12.5.

2. Pavarësisht përcaktimeve në paragrafin 1 të këtij neni, banka i shton totalit të aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun vetëm vlerën pozitive që rezulton nga rritja e klasave në aktiv të bilancit “veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “veprime në valutë me tituj” me jorezidentët të periudhës raportuese krahasuar me të njëjtën periudhë të dy viteve më parë, pasi të jetë zbritur vetëm vlera e shtuar e detyrimeve ndaj jorezidentëve në valutë të të njëjtave klasa të periudhës raportuese krahasuar me të njëjtën periudhë të dy viteve më parë.

3. Përlllogaritjet sipas përcaktimeve të paragrafit 2, bëhen sipas formularit 1, aneksi 8.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gent Sejko

ANEKS 8
FORMULARI I RAPORTIMIT NR.1

Llogaritja e rritjes së totalit të aktiveve të ponderuara me rrezik, bazuar në klasat “Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “Veprimet me letrat me vlerë” jorezidente në valutë
(në mijë lekë)
Emri i bankës
Periudha raportuese
Data e raportimit
Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)
Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

Nr.	Llogaritja e rritjes së totalit të aktiveve të ponderuara me rrezik, bazuar në klasat “Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “Veprimet me letrat me vlerë”, të jorezidentëve në valutë	Mënyra e llogaritjes
1.	Totali i zërave të aktivit “Veprime me thesarin dhe transaksione ndërbankare” dhe “Veprime me letrat me vlerë” të jorezidentëve, në valutë, i dy viteve më parë ¹ .	(a)
2.	Totali i zërave të aktivit “Veprime me thesarin dhe transaksione ndërbankare” dhe “Veprime me letrat me vlerë”, të jorezidentëve, në valutë, në periudhën raportuese.	(b)
3.	Rritja e zërave të aktivit “Veprime me thesarin dhe transaksione ndërbankare” dhe “Veprime me letrat me vlerë”, të jorezidentëve, në valutë.	(c) = (b) - (a)
4	Totali i zërave të pasivit “Veprime me thesarin dhe transaksione ndërbankare” dhe “Veprime me letrat me vlerë” të jorezidentëve, në valutë, e dy viteve më parë ¹ .	(d)
5	Totali i zërave të pasivit “Veprime me thesarin dhe transaksione ndërbankare” dhe “Veprime me letrat me vlerë” të jorezidentëve, në valutë, në periudhën raportuese.	(e)
6	Rritja e zërave të pasivit “Veprime me thesarin dhe transaksione ndërbankare” dhe “Veprime me letrat me vlerë”, të jorezidentëve, në valutë.	(f) = (e) - (d)
7.	Shtesa e totalit të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik.	$(g) = 0$ nëse $(c) \leq 0$ ose $(c) < (f)$; $(g) = (c)$ nëse $(f) < 0$ $(g) = (c) - (f)$ nëse $(f) > 0$

¹ Nëse periudha raportuese është mars 2017, e njëjta periudhë e dy viteve më parë është mars 2015; nëse periudha raportuese është qershor 2017, e njëjta periudhë e dy viteve më parë është qershor 2015; kështu me radhë për periudhat e tjera raportuese.

